

**RELACION PËR PROJEKT-VENDIMIN
“PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË NDËRTEHAVE QË
PËRJASHTOHEN NGA DETYRIMI I PIKËS SË AKSESIT PËR
INFRASTRUKTURËN E RRJETEVE TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE”**

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projekt-vendimi “Për përcaktimin e kategorive të ndërtesave që përjashtohen nga detyrimi i pikës së aksesit për infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike” është propozim i Ministrit për Infrastrukturën dhe Energjinë, në përputhje me pikën 2, të nenit 20, të Ligjit Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”.

Ky projekt-vendim synon plotësimin e kuadrit nënligjor në zbatim të Ligjit Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit” dhe përcaktimin e kategorive të ndërtesave që përjashtohen nga detyrimi i pikës së aksesit për infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projekt-vendimi është parashikuar në programin analitik të akteve për vitin 2018 dhe vjen si nevojë e plotësimit të kuadrit nënligjor, në zbatim të ligjit Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit”, në pikën 2, të nenit 20 ka parashikuar në vija të përgjithshme, kategoritë e ndërtesave që mund të përjashtohen nga detyrimi i pikës së aksesit në godinë. Ky projekt-vendim synon të përcaktojë me detaje se cilat janë këto kategori ndërtesash, të cilat

përrjashtohen nga ky detyrim. Dhe vjen si nevojë e plotësimit të kuadrit nënligjor të parashikuar me ligjin nr. 120/2016.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projekt-vendimi është hartuar në mbështetje të nenin 100 të Kushtetutës, si dhe të nenit 20, pika 2 e Ligjit Nr. 120/2016 *“Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”*.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projekt-vendimi nuk transponon ndonjë akt të veçantë të acquis të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projekt-vendimi, i cili përcakton kategoritë e ndërtesave që përjashtohen nga detyrimi i pikës së aksesit për infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike, përmban dy pika, ku në njërin pikë, të cilës i bashkëlidhet shtojca, detajohen se cilat janë kategoritë që përjashtohen nga detyrimi i pikës së aksesit në godinë, ndërsa në pikën tjetër ngarkon autoritetet planifikuese në nivel qendror dhe vendor për zbatimin e këtij projektakti. Ky parashikim është ne përputhje me sa përcaktohet në pikën 1 të nenit 20 të ligjit nr. 120/2016 sipas se ciles: *“Autoriteti planifikues, në momentin e miratimit të lejes së ndërtimit, siguron që të gjitha ndërtesat shumëpërdorimshe, godina me shumë apartamente banimi ose struktura me disa biznese, të jenë të pajisura me pikë aksesit për infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve. I njëjti detyrim do të aplikohet në rastet e miratimit të lejeve të rikonstruksioneve, riparimeve apo rindërtimit, që kërkojnë leje ndërtimi, sipas legjislacionit në fuqi.”*

Në kategoritë e ndërtesave që i nënshtrohen përjashtimit për detyrimin e pikës së aksesit në godinë janë:

Ndërtesat në përdorim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe/ose forcave ushtarake, si dhe godinat në përdorim për qëllime sigurie kombëtare; Ndërtesat që përfshihen në listën e monumenteve kulturore, qendrat, zonat dhe parqet arkeologjike në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi në rastet kur ndërtimi i kësaj pike është e papranueshme për aspektet e ruajtjes së vlerës kulturore, arkeologjike të

tyre. Ky përjashtim është si për ndërtesat e reja ose rikonstruksionet e godinave ekzistuese, për të cilat ndërtimi i infrastrukturës fizike me shpejtësi të lartë, mund të ndryshojë përdorimin dhe paraqitjen e jashtme të tyre. Një kategori tjetër përjashtimi është për ndërtesa në zonat e izoluara ku prespektiva për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë, nuk e justifikon pajisjen e godinës me infrastrukturë fizike të gatshme për komunikime me shpejtësi të lartë ose me një pikë akses. Gjithashtu ndërtesat që shërbejnë si hangarë, sera, garazhe, magazina apo dhe ndërtesat e vogla të shërbimeve, që nuk sigurojnë akomodim për fjetje janë pjesë e përjashtimit nga ky detyrim.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet që ngarkohet për zbatimin e këtij projekt-vendimi janë autoritetet planifikuese sipas legjislacionit në fuqi.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projekt-vendimi është hartuar nga një grup pune dhe është mbështetur në praktikat e ndjekura në vende të tjera. Projektvendimi do t'i nënshtrohet konsultimit me grupet e interesit si dhe me autoritetet planifikuese.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projekt-vendimi nuk ka ndikim në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI